



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
KUÇOVË

Nr. 3293 Prot.

Kuçovë, më 29. 9. 2023

V E N D I M

Nr. 24, datë 26 / 09 / 2023

Për

**“Miratimin e dhënies së ndihmës financiare, për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të tjera, nga shpërthimi i bomblës së gazit së datës 07.05.2023”.**

1. Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin nr.64 pika a dhe c, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Komisioni i Emergjencave Civile, ligjit nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, si dhe në zbatim të V.K.M nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” si dhe mbështetur në shkresën nr. 488/1 Prot. datë 13.06.2023 nga Këshilli i Qarkut Berat, protokolluar në institucionin tonë me nr.1578/1 Prot. datë 15.06.2023, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi i bomblës së gazit, në banesën e cila është në pronësi të Z. Nikollaq Mustafa Kastano dhe Znj. Marie Bajram Kastano.

**VENDOSI:**

2. Miratimin e fondit të emergjencës sipas preventivit të hartuar nga Këshilli i Qarkut Berat referuar shkresës me nr.488/1 Prot. datë 13.06.2023, protokolluar në institucionin tonë me nr. 1578/1 Prot. datë 13.06.2023, të shkaktuara nga shpërthimi i bomblës së gazit, në në lagjen nr.1 blloku “ 11 Janari”, banesë e cila është në pronësi të Z. Nikollaq Mustafa Kastano dhe Znj. Marie Bajram Kastano.

3. Vlerësimin total të dëmeve me shumën **2,003,339 lekë**, ku në zbatim të ligjit të sipërpërmendur do të dëmshpërblehen me 50% të shumës së preventivit, ku shuma përfituese është **1,001,669.5 lekë**
4. Dhënia e ndihmës financiare të dëmshpërblehen nga Bashkia Kuçovë.
5. Ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua 18 vota pro; - kundër;  
- abstenim; 11 këshilltaret prezent

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**ALEKSANDËR ZIU**

